- VJIMËSIA e veprimtarisë ekonomike të njësive sonë raportuese është e sigurt duke mos patur në plan ose nevojë ndërprerjen e aktivitetit të saj.
- KOMPESIMI, midis një aktivi dhe një pasivi nuk ka, ndërsa midis të ardhurave dhe shpenzimeve ka vetëm në rastet që lejohen nga SKK.
- KUPTUESHMËRIA e Pasqyrave Financiare është realizuar në masën e plotë për të qenë të qartë dhe të kuptueshme për përdorues të jashtëm që kanë njohuri të përgjithshme dhe të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit.
- MATERIALITETI është vlersuar nga ana e jonë dhe në bazë të tij PF "pasqyrat financiare" janë hartuar vetëm për zëra materiale.

HEKURUDHA SHQIPTARE SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

- f) **BESUESHMËRIA** për hartimin e pasqyrave financiare është e sigurtur pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e mëposhtme:
- Parimin e paraqitjes me besnikëri
 - Parimin e përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore.
 - Parimin e paanshmërisë pa asnjë influencim të qëllimshëm.
 - Parimin e maturisë pa optimizëm të tepruar.
 - Parimin e plotësisë duke paraqitur një pamje të vërtetë e të drejt të PF.
 - Parimin e qëndrueshmërisë për të mos ndryshuar politikat e metodat kontabël.
 - Parimin e krahasueshmërisë duke sigurtur krahasimin midis dy periudhave.

A-II Politikat kontabële.

Pasqyrat financiare janë pregatitur në përputhje me Ligjin Nr. 9928 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", dhe kuadri kontabël i aplikuar është në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK2).

Këto pasqyra financiare janë pregatitur mbi bazën e kostos historike, përveç vlerave monetare që janë sipas vlerës së drejtë. Pasqyra financiare janë paraqitur në lekë që është dhe monedha funksionale e shoqërisë. Pregatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhimi të bëjë gjykime, vleresime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vleresime. Vleresimet dhe supozimet e nënkuptuara janë rishikuar në vazhdimësi.

Rishikimet e vleresimeve kontabël njihen në periudhen në të cilën bëhet rishikimi dhe jo në retrospektivë. Në veçanti informacioni mbi fusha të rëndësishme të pasigurisë së vleresimit dhe gjykimit kritik në përputhje me politikat kontabël që kanë efektet më domethënëse në shumat e njohura në pasqyrat financiare.

Përmbledhje e politikave kontabël.

Politikat kontabële të dhëna më poshtë janë aplikuar që nga 01.01.2017 dhe janë në përputhje me parimet bazë të përshkruara në Ligjin nr. 9228 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Për përcaktimin e kostos së inventareve është zgjedhur metoda "FIFO hyrje e parë, dalje e parë (SKK4). Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM që plotëson kriteret për njohje si aktiv në bilanc është vlersuar me kosto (SKK 5;11). Aktivët afatgjatë materiale paraqiten me koston e tyre historike. Shoqëria për këtë vit nuk ka rivlerësuar aktivët afatgjatë materiale (AAM).

Transaksionet në monedhë të huaj, Transaksionet në monedhë të huaj janë këmbyer me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj janë kthyer me kursin e këmbimit në mbyllje të vitit. Diferencat nga kursi i këmbimit janë të njohura në pasqyrën e fitimit në rezultat neto të këmbimit. Aktivët dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj që janë paraqitur me kosto historike janë kthyer me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Aktivët dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj që janë paraqitur me vlerë tregu janë kthyer me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e tregut.

Normat e këmbimit (lekë për monedhë të huaj) për monedhat kryesore më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
1 EUR	132.95	135.23
1 USD	111.10	128.17

Instrumentat financiarë,

Instrumentat financiarë jo-derivative përfshijnë investimet në letra me vlerë të kapitalit, në llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare në arkë dhe në bankë, kredi dhe hua, llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme. Më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 nuk ka instrumenta financiarë derivativë.

HEKURUDHA SHQIPTARE SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim).

Asetet financiare janë matur fillimisht me vlerën e drejtë duke shtuar kostot e transaksionit që janë të lidhur direkt me përvetësimin e tyre. Njohja në vazhdim e aktiveve financiare jo derivative përshkruhet si më poshtë.

Mjetet monetare në arke dhe në bankë përfshijnë tepricat në para, Overdraftet e ripagueshme me kërkesë dhe që formojnë pjesë integrale në administrimin e mjeteve monetare të shoqërisë, për qëllime të pasqyrës së fluksit të arkës. Regjistrimi kontabël për të ardhurat financiare dhe shpenzimet është sqruar në shënimin e mëposhtëm.

Instrumentat financiarë për shoqëri të lidhura.

Shoqëri të lidhura janë ato entitete në të cilat ne kemi influence sinjifikative, por nuk kemi kontroll mbi politikat financiare dhe operative.

Kapitali aksioner,

Kapitali i aksionereve të Shoqërisë njihet me vlerë nominale.

Dividentët,

Dividentët njihen si detyrim për periudhën në të cilën ata deklarohen.

Të tjera,

Aktive të tjera financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Aktive afatgjata materiale.

Njohja dhe matja,

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me koston e tyre historike. Në vitin 2013 Shoqëria ka kryer rivlerësimin e fundit të aktiveve afatgjata materiale, i cili është miratuar nga ana e ish MZHTTS me shkresë nr.8504/3 dt.17.02.2015, në zbatim të secilës janë kryer veprimet në kontabilitet (PF) të vitit ushtrimor 2014, kjo me urdhër të administratorit të shoqërisë me nr.220/I dt.24.03.2015.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë bërë direkt "të atribueshme" për blerjen e aktivit. Kostot e aktivit të ndërtuara nga vetë shoqëria, përfshijnë koston materiale dhe të fuqisë puntore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet direkt me venien e aktivit në kushte pune, si dhe kostot e çmontimit dhe të zhvendosjes dhe të magazinimit të tyre në vendndodhjen përkatëse. Kosto e financimit në lidhje me blerjen apo ndërtimin e aktiveve specifike njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, me të ndodhur.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentë kryesor) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale vendosen duke krahasuar të hyrat monetare nga shitja me vlerën e mbartur të aktiveve materiale të trupezuara, dhe njihen me neto brenda zërit "të ardhura të tjera", në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kur aktivet e rivlerësuara shiten, sasitë e përfshira në rezervën e rivlerësimit transferohen në fitimin e mbartur, ndërsa deficieti i rivlerësimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimit të periudhës.

Kostot e mëpasshme,

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të aktiveve afatgjata materiale njihen në vlerën e mbartur të një zeri, nëse është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme të trupezuara në pjesë do të qarkullojnë në Shoqëri dhe kostoja e saj mund të vlerësohet besueshëm. Vlera e mbartur e pjesëve të zëvendësuara nuk njihet.

Kostoja e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve, kur ndodhin.

Amortizimi,

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me bazë "me metodën zbritëse" si për ndërtesat, instalime të përgjithshme, makineritë dhe pajisjet, mjetet e transportit, pajisjet e

HEKURUDHA SHQIPTARE SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

zyrës e paisjet kompjuterike dhe aktivet e tjera me një normë amortizimi siç është shpjeguar me poshtë. Toka dhe punimet në proces nuk amortizohen.

Normat e amortizimit për AAM janë llogaritur mbi bazën e normave teknike (të përshtatshme për sistemin hekurudhor) që janë miratuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës nr.24 dt.18.12.2006.

Normat e amortizimit që janë aplikuar sipas këtij vendimi të Këshillit Mbikqyrës janë më të ulta se normat e amortizimit « fiskale », të percaktuara në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat".

Aktive afatgjata jomateriale,

Tarifat e konsulcences dhe të vlerësuesve të pavarur kapitalizohen si aktive afatgjata jomateriale. Nuk është bërë një vlerësim nëse shpenzimet e kërkimit klasifikohen në perputhje me SNK 3 ose nuk ka një analizë nëse në lidhje me fizibilitetin e tij tregtar ose teknologjik, dhe nëse kostot mund të maten në mënyrë të besueshme.

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me bazë lineare mbi jetën e dobishme të aktiveve afatgjata jomateriale nga momenti apo data që ato janë gati për përdorim. Jeta e dobishme për aktivet afatgjata jomateriale në 31.12.2017 është midis 5 dhe 10 vjeteve, po kështu dhe në vitin 2016, "5-10 vjet".

Inventari,

Inventari vlerësohet me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës së realizueshme.

Kostoja e inventarit bazohet në koston mesatare të ponderuar, dhe përfshin shpenzime të ndodhura gjatë blerjes së inventarit, kosto prodhimi ose kosto transformimi dhe kosto të tjera të lidhura me sjelljen e tyre në kushtet dhe pozicionin ekzistues. (Në rastin e inventarit të prodhuar dhe prodhimit në proces, kosto përfshin një pjesë të caktuar shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit bazuar në kapacitetin normal të aktivitetit).

Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i vlerësuar në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e finalizimit dhe shpenzimet e shitjes.

Aktivitet financiar,

Një aktiv financiar vlerësohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse egziston ndonjë tregues për përkeqësimin e aktivitetit. Një aktiv financiar konsiderohet për tu përkeqësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose më shumë ngjarje kanë patur një efekt negativë në flukset e ardhshme të vlerësuara të aktivitetit.

Një humbje nga përkeqësimi i lidhur me një aktiv financiar të vlerësuar me kosto të amortizuar, llogaritet si difference midis vlerës së mbetur dhe vlerës së tashtme të flukseve të ardhshme të parashikuar të skontuar me normën efektive të interesit. Një humbje nga përkeqësimi i një aktivi financiar të mbajtur për shitje llogaritet duke iu referuar vlerës së tij të drejtë. Aktivitet financiar që janë individualisht të mëdhenj testohen për përkeqësim në mënyrë individuale.

Aktivitet e mbetura financiare vlerësohen së bashku në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga përkeqësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Cdo humbje e akumuluar e lidhur me ndonjë aktiv financiar të mbajtur për shitje e njohur me parë në kapital, transferohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga përkeqësimi stornohet nëse stornimi mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga përkeqësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar dhe aktivitet financiar të mbajtura për shitje që janë letra me vlerë të borxhit, stornimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Për aktivitet financiar të mbajtura për shitje që janë letra me vlerë të kapitalit, stornimi njihet drejtpërdrejtë në kapital.

Aktivitet jo financiar,

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve të tatimit të shtyrë, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse egziston ndonjë tregues për përkeqësim. Nëse egziston ndonjë tregues i tillë, atëherë duhet vlerësuar shuma e rikuperueshme e aktivitetit. Për emrin e mire dhe aktivitet e paprekshme që kanë jetë të papërcaktuar ose që nuk janë ende të gatshëm për përdorim, shuma e rikuperueshme vlerësohet në çdo datë raportimi.

HEKURUDHA SHQIPTARE SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose e një njësie që gjeneron para është me e madhja midis vlerës së saj në përdorim dhe vlerës së saj të drejtë minus kostot e shitjes. Gjatë vlersimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme, të pritshme të parasë skontohej në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Për qëllime të testimit të përkeqësimit aktivet grupohen së bashku në grupin me të vogël të aktiveve që gjeneron flukset hyrëse të parasë të aktiveve të tjera ose grupeve të tjera të aktiveve ("njësitë që gjenerojnë para").

Një humbje nga përkeqësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësia e tij që gjeneron para tejkalon shumën e tij të rikuperueshme të parashikuar. Humbjet nga përkeqësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Humbjet nga përkeqësimi të njohura në lidhje me njësitë e gjenerimit të para që përdoren me parë për të pakësuar vlerën kontabël të emrit të mirë që mund t'i jetë ngarkuar njësive dhe me pas për të pakësuar vlerën kontabël të aktiveve të tjera të njësise (grupi i njësive) në mënyrë përpjestimore.

Humbjet nga përkeqësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për ndonjë tregues që humbja është pakësuar ose nuk egziston më. Një humbje nga përkeqësimi stornohet nëse ka pasur ndryshim në parashikimet e bëra për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Një humbje nga përkeqësimi stornohet deri në masën që vlera kontabël e aktivit të mos tejkalojë vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar, minus zhvlerësimin ose amortizimin, nëse nuk do të ishte njohur humbje nga përkeqësimi.

Përfitimet e punonjësve,

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore,

Shoqëria paguan vetëm kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore që u sigurojnë përfitime "pensione" punonjësve pas daljes në pension. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për sigurimin e kufirit minimal të caktuar me ligj për pensionet në Shqipëri sipas një plani të përcaktuar kontributesh pensioni. Kontributet e Shoqërisë në planin e përfitimit të pensioneve ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ato ndodhin.

Leje vjetore e paguar,

Shoqëria njihet si detyrim shumë e paskontuar të kostove të parashikuara lidhur me lejen vjetore që pritet të paguhet në kembim të shërbimit të punonjësve për periudhën e përfunduar.

Provizionet për rreziqe,

Një provizion njihet në qoftë se, si rezultat i një ngjarje të shkuar Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose të tërthortë që mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që një fluks dalës përfitimesh ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin.

Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme të pritshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për detyrimin.

Ristrukturimi,

Një provizion për ristrukturim njihet kur Shoqëria ka miratuar një plan të detajuar dhe formal ristrukturimi, dhe ristrukturimi ka filluar ose është shpallur publikisht. Për kostot e ardhshme operative nuk llogaritet provizion.

Restaurim i truallit,

Në përputhje me politikën e publikuar mjedisore të Shoqërisë dhe me kërkesat ligjore në fuqi, një provizion për restaurim truall në lidhje me tokat e ndotura, dhe shpenzimi përkatës njihet kur toka është ndotur.

Kontratat "onerous",

Një provizion për kontratat e onerous njihet kur përfitimet e pritura të Shoqërisë nga një kontratë janë më të vogla se kostot e pashmangshme për të përmbushur detyrimet e saj sipas kontratës. Provizioni matet si vlerë aktuale e më të vogël midis kostos së pritur në rast prishjeje të

HEKURUDHA SHQIPTARE SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

kontratës dhe kostos neto të pritur në rast vazhdimi të kontratës. Përpara krijimit të provizionit, Shoqëria njeh çdo humbje nga përkeqësimi i aktiveve të lidhura me atë kontratë.

Njohja e të ardhurave,

Mallrat e shitur,

Të ardhurat nga shitja e mallrave janë matur me vlerën e drejtë të pagesave të arkëtuara ose të arketueshme, pakësuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet dhe mbi fitimin (akcizat, taksat e rrugës, dhe të tjera të ngjashme). Të ardhurat njihen kur rreziqet dhe përfitimet nga pronësia janë transferuar te blerësi, arketimi i pagesave është i mundshëm, kostot e lidhura dhe kthimi i mundshëm i mallrave mund të parashikohen në mënyrë të besueshme, nuk ka pjesëmarrje të mëtejshme në menaxhimin e mallrave dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme. Transferimet e rreziqeve dhe të përfitimeve ndryshojnë në varësi të kushteve specifike të kontratës së shitjes.

Shërbimet,

Të ardhurat nga shërbimet e kryer janë njohur si fitim ose humbje në përpjestim me fazën e përfundimit të transaksionit në datën e raportimit. Faza e përfundimit vlerësohet duke iu referuar inspektimeve të punës së kryer.

Të ardhurat nga qeraja,

Të ardhurat nga qeraja mbi pronat për investime njihen si fitime ose humbje në mënyrë lineare përgjatë afatit të qerasë. Periudhat e dhëna gjatë afatit të qerasë janë njohur si një pjesë integrale e të ardhurave totale nga qeraja, përgjatë afatit të qerasë.

Shpenzimet operative,

Shpenzimet operative njihen atëherë kur ato ndodhin.

Pagesat e qerasë,

Pagesat minimale të qerasë bërë për qeratë financiare janë ndarë ndërmjet shpenzimit financiar dhe paksimit të detyrimit ekzistues. Shpenzimi financiar është shpërndarë në çdo periudhë përgjatë afatit të qerasë në mënyrë që të paraqesë një normë të pandryshueshme interesi mbi tepicën e mbetur të detyrimit. Pagesat e mundshme të qerasë kontabilizohen duke shqyrtuar pagesat minimale të qerasë përgjatë afatit të mbetur të qerasë, pasi të konfirmohet korigjimi i qerasë.

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare,

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi i balancave me bankat dhe të ardhurat nga këmbimi valutash që njihen si fitime ose humbje. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazë rrjedhëse, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet nga këmbimi valutash.

Tatimi mbi fitimin,

Tatimi mbi fitimin ose humbjen për vitin përfshin tatimin aktual dhe atë të shtyre. Tatimi mbi fitimin është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur drejtpërdrejt në kapital, rast në të cilin ai njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pagueshëm i pritshëm mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e hartimit të bilancit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e kaluara.

Tatimi i shtyre llogaritet duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit, duke siguruar diferencat e përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Shuma e llogaritur e tatimit të shtyre bazohet në mënyrën e pritur të realizimit ose shlyerjes së vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e përgatitjes së bilancit.

Një aktiv i shtyrë tatimor njihet vetëm në qoftë se ekziston mundësia e realizimit të fitimeve të tatueshme përkundrejt të cileve aktivitet mund përdoret. Aktivitet tatimor të shtyrë reduktohen në momentin që nuk është me e mundur që përfitimet tatimore të lidhura me to të realizohen.

HEKURUDHA SHQIPTARE SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

B. Shënimet që shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare.

Aktivët Afatgjatë Materiale.

Më 31 Dhjetor 2017 Aktivët Afatgjatë Materiale paraqiten si më poshtë:

Ne 000/lekë

	Toka (Truall)	Ndërtesa dhe instalime	Makineri	Mjete Transporti	Pajisje dhe informatikë	TOTAL
AAM Vlera Bruto						
Gjendje 01.01.2017	43.620.810	53.765.186	865.422	4.112.174	36.792	102.400.384
Shtesa (blerje)		7.006	531		311	7.848
Shtesa (te tjera+sistemi.)		102			268	370
Pakësime (J-Pendocimi)				-450.173	-448	-450.621
Pakësime (ne shitje)	-25.452	-83.683				-109.135
Riklasifikime nga CIP						
Tjetër (sistemime)			-125	-1.352	-268	-1.745
Gjendje 31.12.2017	43.595.358	53.688.611	865.828	3.660.649	36.655	101.847.101
Cvlersimi akumuluar						
Gjendje 01.01.2017	0	13.928.049	445.516	2.364.262	22.439	16.760.266
Shtesa (amort.2017)		423.824	15.715	64.889	975	505.403
Shtesa (te tjera+sistemi.)		34		0	8	42
Pakësime		-51.791	-0	-306.494	-0	-358.285
Pakësime (sistemime)			-47	-1.328	-394	-1.769
Riklasifikime nga CIP						
Tjetër						
Gjendje 31.12.2017	0	14.300.116	461.184	2.121.329	23.028	16.905.657
Vlera mbetur neto						
Gjendje 01.01.2017	43.620.810	39.837.137	419.906	1.747.911	14.354	85.640.118
Gjendje 31.12.2017	43.595.358	39.388.495	404.644	1.539.320	13.627	84.941.444

AAM janë njohur në kontabilitet me koston e blerjes së tyre dhe shoqëria ka zgjedhur si politike të saj kontabile modelin e koston ku çdo element i AAM paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar. Ajo nuk ka akumuluar as një humbje nga zhvlersimi.

Normat e amortizimit të zbatuara siç theksuam më lartë janë ato të percaktuara në vendimin e Drejtorisë së Shoqërisë (Këshillit Mbikqyrës me nr.24 dt.18.12.2006) dhe jo me normat fiskale të percaktuara në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat".

Normat e amortizimit që janë aplikuar sipas këtij vendimi të këshillit mbikqyrës të HSH-së janë norma teknike që i janë përshtatur aseteve të HSH "sistemit hekurudhor".

Shoqëria nga viti 2006 e në vazhdim ka kryer dy here rivleresimin e aktiveve afatgjatë materiale (rivlersimi i kryer me gjendjen e datës 31.12.2006 dhe të datës 31.12.2013).

Rivlersimi i fundit është miratuar nga ana e ish Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtise, Transportit dhe Sipërmarrjes (aktualit Ministria e Financave dhe Ekonomise) sipas shkresës nr.8504/3 dt.17.02.2015, në zbatim të secilës janë kryer veprimet në kontabilitet (PF) të vitit 2014 me urdhër të administratorit të shoqërisë me nr.220/1 dt.24.03.2015.

Gjatë këtij viti shoqëria nuk ka marrë asnjë rivleresim të aktiveve ose përkeqësim.

HEKURUDHA SHQIPTARE SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

Aktivitet Afatgjatë Materiale (vazhdim).

Levizjet në vlerë të AAM përbëhen: Llog.211, për vitin ushtrimor 2017 ka lëvizje në paksim me vlerë 25.452 mijë lekë, lëvizje kjo e cila i përket Nj.BMIH që përfaqëson kalimin për shitje të truallit me objekt kapanoni i ri i vagonave. Ky paksim është bërë sipas urdhërit të Ministris Financave dhe Ekonomisë me nr.14379/1 datë 09.11.2017.

Llog.212, ka shtesa në vlerën 7.108 mijë lekë, e cila përbëhet; blerje të reja me fondet buxhetore 7.006 mijë lekë (riaftesimi i trases zona, Durres, Elbasan, Milot dhe Fier me vlerë 2.184 mijë lekë, riparim traseje km 138-400 Bajz-Hani Hotit me 660 mijë lekë, rikonstruksioni i linjës Librazhd-Prezjas me 3.917 mijë lekë, godina parafabrikate st.Domje me 245 mije leke), ndërsa vlera për 102 mijë lekë përfaqëson sistemim i brendshëm e ardhur nga llog.213 (punime sinjalizim-nderlidhje). Të gjitha këto veprime i përkasin Nj.BMIH.

Paksime në këtë llogari për vitin 2017 janë 83.684 mijë lekë, vlerë kjo e cila i përket Nj.BMIH që përfaqëson kalimin për shitje të objektit kapanoni i ri i vagonave. Siç permendem me larte ky paksim (shitje) është bërë sipas urdhërit të Ministrit Financave dhe Ekonomisë me nr.14379/1 datë 09.11.2017.

Llog.213, ka shtesa, blerje me fondet e veta të hekurudhës me vlerë 531 mije leke e cila përfaqësohet, blerje te reja 93 mije leke "2 tra bllokues", 80 mije leke "krah kalese st.Domje", 358 mije leke "furnizim me uje ne st.Kasharë". Paksimet rezultojnë me vlerë 125 mijë lekë përfaqëson, sistemim i brendshëm e kaluar ne llog.212 (punime sinjalizim-nderlidhje), dhe vlera per 23 mije leke ka kaluar ne llogarit e klases 3(depo). Këto veprime i përkasin Nj.BMIH. Vlera për 71.557 mijë lekë "hyrje dhe dalje" përfaqëson levizje të brendshme mes Nj.SHML dhe Nj.BMIH për paisjet e sektorit të avarive hekurudhore.

Llog.215, për vitin ushtrimor 2017 nuk ka shtesa, ndërsa paksimet rezultojnë me vlerë në total 451.525 mijë lekë, të cilat përbëhen nga; 450 173 mijë lekë dalja jasht përdorimi (Nj.BM me 392.575 mijë lekë "vagona malli" dhe Nj.BU me 57.598 mijë lekë "vagona udhëtarë"). Vlera për 1.352 mijë lekë tek Nj.BU, përfaqëson sistemim nga llog.215 tek llog.327 (bateri për mjet e transportit "inventar i imët në përdorim"). Vlera për 5.669 mijë lekë "hyrje dhe dalje" përfaqëson levizje të brendshme mes Nj.SHML dhe Nj.BMIH për mjete transporti.

Llog.218, shtesa me vlerë 311 mijë lekë, përbëhet nga blerje të reja me fonde të brendshme (Nj.BMIH me 153 mijë lekë dhe HSH qendër me 158 mijë lekë). Paksimet e ndodhura në këtë grup asete janë në vlerën 448 mijë lekë, vlerë kjo e cila ka ardhur nga dalje jashtë përdorimi të aseteve (HSH qendër), 268 mijë lekë është kalim nga depo ne perdorim "HSH qendër". Dalja jashtë përdorimi e inventarit ekonomik në HSH qendër është miratuar me vendim të Administratorit "me nr.02 datë 27.02.2018".

Vlera për 1.197 mijë lekë "hyrje dhe dalje" përfaqëson levizje të brendshme mes Nj.BU dhe Nj.BMIH me 1.126 mijë lekë dhe HSH qendër me Nj.SHML për 72 mijë lekë.

Lëvizjet në vlerë të amortizimit të AAM, paraqitet sa vijon;

Lëvizja e Llog.281/2, shtesa me vlerë 423.858 mijë lekë përfaqëson; amortizimin e vitit 2017 423.823 mijë lekë (Nj.BMIH me vlere 419.864 mijë lekë dhe Nj.SHML me 3.959 mijë lekë), si dhe shtesa me vlerë 35 mijë lekë përfaqëson sistemim veprimi nga llogaria 281/3 (e ardhur kjo nga Nj.BMIH). Paksimet në këtë llogari për vitin 2017 rezultojnë me vlere 51.791 mije leke vlerë kjo e cila i përket Nj.BMIH që përfaqëson kalimin për shitje objekt kapanoni i ri i vagonave. Siç permendem me larte ky paksim është bërë sipas urdhërit të Ministrit Financave dhe Ekonomisë me nr.14379/1 datë 09.11.2017.

Lëvizja e Llog.281/3, shtesa me vlerë 15.715 mijë lekë e cila përfaqëson vetëm vlerën e amortizimi për vitin 2017 (Nj.SHML me 4.611 mijë lekë dhe Nj.BMIH me 11.104 mijë lekë) Paksimi në këtë llogari është me vlere 47 mije leke përfaqëson sistemim te brendshem nga ana e Nj.BMIH, tek llog.281/2 me 35 mije leke dhe 12 mije leke kalim ne llogarin e klases 3 (depo).

HEKURUDHA SHQIPTARE SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

Vlera për 37,174 mijë lekë "hyrje dhe dalje" përfaqëson levizje të brendshme mes Nj.SHML dhe Nj.BMIH për paisjet e sektorit të avarive hekurudhore.

Lëvizja e **Llog.281/5**, shtesa me vlerë **64.889** mijë lekë përfaqëson vetëm amortizimin e vitit 2017 (Nj.BMIH me 5.262 mijë lekë, Nj.SHML me 10.213 mijë lekë, Nj.BM me 32.665 mijë lekë, Nj.BU me 16.657 mijë lekë dhe HSH qendër me 92 mijë lekë).

Paksimet rezultojnë me vlerë në total **307.822** mijë lekë, të cilat përbëhen nga; 306 494 mijë lekë dalje jashtë përdorimi (Nj.BM me 268.712 mijë lekë "vagona malli" dhe Nj.BU me 37.782 mijë lekë "vagona udhëtarë"). Vlera për 1.328 mijë lekë tek Nj.BU, përfaqëson sistemin nga llog.215 tek llog.327 (bateri për mjet e transportit "inventarë i imët në përdorim").

Vlera për 1.683 mijë lekë "hyrje dhe dalje" përfaqëson levizje të brendshme mes Nj.SHML dhe Nj.BMIH për amortizimin e mjeteve të transportit.

Lëvizja e **Llog.281/8**, shtesa me vlerë **983** mijë lekë përfaqëson; vlerë amortizimi për vitin 2017 me 975 mijë lekë (Nj.BMIH me 343 mijë lekë, Nj.SHML me 94 mijë lekë, Nj.BM me 89 mijë lekë, Nj.BU me 123 mijë lekë dhe HSH qendër me 326 mijë lekë), vlera për 8 mijë lekë tek Nj.SHML, e cila përfaqëson sistemin veprimi nga amortizimi i periudhave të mëparshme.

Paksimet në këtë llogari për vitin 2017 kapin vlerën 394 mijë lekë, e cila përbëhet vetëm nga dalje jashtë përdorimi në HSH qendër, kjo me vendim të Administratorit të Shoqërisë me nr.02 datë 27.02.2018. Vlera për 1.083 mijë lekë "hyrje dhe dalje" përfaqëson levizje të brendshme mes HSH qendër me Nj.SHML për 54 mijë lekë dhe Nj.BMIH me Nj.BU për 1.029 mijë lekë për amortizimin e mjeteve të inventarit ekonomik që janë transferuar.

4. Inventaret

Gjendja e inventarëve gjatë periudhës 1/Janar/2017 deri në 31/Dhjetor/2017 paraqitet si më poshtë:

Ne 000/leke			
	Gjendja inventarëve në fillim të periudhës	Lëvizjet dhe blerjet e periudhës	Gjendja e inventarëve në fund të periudhës
Produkte të gatshme	52,479	(-23,225)	29,254
Prodhime në proces	5,850	(-34)	5,816
Lëndë të para, të konsumueshme, pjesëndërrimi.	215,546	(-38,017)	177,529
Mallra për rishitje+tjera.	3,408	103	3,511
Inventarët	11,199	(-191)	11,008
Subtotal	288,482	(-61,364)	227,118
Zhvlerësime për inventarët e vjetëruar.	5,600	(-96)	5,504
Total	282,882	(-61,268)	221,614

Zhvlerësime në fundin e periudhës të artikujve të vjetëruara të analizuar si vijon:

	Gjendje 31.12.2017	Gjendje 31.12.2016
Produkte të gatshme	0	0
Lëndë të para, të konsumueshme, pjesë ndërrimi.	0	0
Mallra për rishitje.	0	0
Nënprodukte dhe mbeturina	29,254	52,479
Total	29,254	52,479

HEKURUDHA SHQIPTARE SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

Siç shikohet nga këto të dhëna shoqëria si rezultat i situatës së vështirë financiare nuk ka patur blerje të reja materiale, pra ka përdorur materialet e trashëguara në depo.

Inventaret janë njohur me koston e tyre të blerjes. Për të përcaktuar koston e tyre është përdorur metoda e drejtë "pra me çmim blerje". Shoqëria në zbatim të urdherit të Administratorit të Shoqërisë nr.837 dt.27.10.2017 ka kryer inventarin fizik të pasurisë (aseteve) të saj.

Nënvizojmë se Shoqëria (HSH) nuk ka kryer rivlersim të inventareve për vitin 2017 me përjashtim të rivlersimit fundit të aseteve i kryer në vitin 2013, siç kemi përmendur më lart.

5. Kërkesa të arkëtueshme

Më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 Kërkesat e Arkëtueshme paraqiten si më poshtë:

	31/12/2017	31/12/2016
Klientë për mallra, produkte e shërbime	9,335	5,336
Klientë për aktive afatgjata	0	0
Klientë të tjerë	0	0
TOTALI	9,335	5,336
Zhvlersim i të drejtave (Klientëve)	0	0
TOTALI NETO (në 000/Lekë)	9,335	5,336

Klientët janë të analizuar në mënyrë individuale (analitike), ku nënvizojmë se këto detyrime janë të arritshme për tu arkëtuar në muajt e parë të vitit 2018, sepse i përkasin klienteve të muajve të fundit të vitit ushtrimor 2017, pra dhe janë të besueshëm.

6. Kërkesa të tjera të arkëtueshme

Më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 Kërkesat e tjera të Arkëtueshme paraqiten si më poshtë:

	31/12/2017	31/12/2016
Debitorë pa shpresë arkëtimi (llog.416)	735,795	735,795
Parapagime të dhëna	0	0
Detyrime nga punëmarsi (llog.427)	267	284
Sigurimet shoqërore/shëndetësore për raportet	236	326
Tatim mbi fitimin (teperica debitore)	0	0
Shteti -TVSH për t'u marrë (445)	50,259	174,748
Tatime të shtyra (teperica debitore)	0	0
Të drejta ndaj ortakëve dhe aksionerve	0	0
Debitorë të tjerë "me konflikt" (llog.4671)	108,572	92,473
Shuma	895.129	1.003.626
Zhvleresim i të tjera kërkesave (469)	735,795	735,795
Total (në 000/lekë)	159,334	267,831

Detyrimet e kontabilizuara në llog.416 me vlerë 735,795 lekë përfaqëson vlerë e detyrimeve për të cilën nga ana e drejtimit të shoqërisë janë krijuar provigjone (viti 2008).

Detyrimet e kontabilizuara në llog.4671 me vlerë 108,572 mijë lekë nga 92,473 mijë lekë në vitin 2016 përfaqëson debitor me konflikt prej disa vitesh, ku mundësia e arkëtimit të kësaj vlere [me përbërje 40 subjekte (raste)] është e pakët.

Nënvizojmë se në vitin 2017 kjo llogari është shtuar me 16.181 mijë lekë, ku 16.181 mijë lekë ka ardhur nga transferimi i llogarisë 347 (HSH qendër) sipas vendimit të Administratorit të Shoqërisë nr.02 datë 27.02.2018, e cila përfaqëson vlerë kosto skrapë "vlere e munguar" e mbartur nga ish njësitë e HSH para vitit 2009.

Detyrimet e tjera për detyrimet e punonjësve me vlerë 267 mijë lekë dhe vlera e përfitimeve e sigurimeve shoqërore për 236 mijë lekë janë të arkëtueshme.

HEKURUDHA SHQIPTARE SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

Këto llogari si të gjitha llogaritë e tjera janë të analizuara në mënyrë analitike për çdo subjekt dhe persona me vlera dhe sipas periudhave të krijimit të detyrimeve.

Vlera për 735,795 mijë lekë (llog.469),të përmendur më lartë përfaqëson vlerën e provigjoneve për detyrimet e pasqyruara në llogarinë 416 (pra është kundërparti e llogarisë 416).

Nga viti 2008 e deri në këto momente nuk kemi patur rivlersim (arketime të mundshme).

Nënvizojmë se detyrimi i tvsh në fund të vitit 2017 rezultoi me saldo debitore për 50,259 mijë lekë , nga 174,748 mijë lekë që ishte në vitin 2016,për të cilën theksojmë se here pas here janë kërkuar rimbursime (shkresat me nr.69 datë 21.01.2011 dhe nr.309 datë 17.04.2012),por sqarojmë se,për kërkesën e parë vazhdon procedura gjyqësore, ndërsa kërkesa e dytë është njohur rimbursimi për 43.8 milion lekë,por Dr.Rajonale Tatimore Durrës,"sipas saj ka bërë kompesim të detyrimeve të mëparshme",pra për atë vlerë që jemi në proces gjyqësor.

Në muajin Nëntor 2015 është bërë kontrolli nga ana e organit tatimor ,ku veprimet e rimbursimit me vlerë rreth 38 milion lekë janë kryer "arketuar" me dy këste në vitin ushtrimorë 2017.

Bëjmë me dije se me vendim të Administratës së Shqetësimit me nr.02 datë 27.02.2018 kemi kryer kalimin në rezultat të vlerës 76.730 mijë lekë ,vlerë kjo e cila përfaqëson vlerë rimbursimi të TVSH-se e pa njohur nga organi tatimorë "sipas njoftimit vlersimit nr.10460/4 datë 29.07.2011 dhe vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me nr.1882 datë 19.05.2014.

Gjithashtu sqarojmë se Shoqëria (HSH) ka bërë rekurs në Gjykatën e lartë "me nr.736 datë 03.07.2014" por deri në këto momente nuk kemi prononcim "pra vendim" nga ana e gjykatës.

Sqarimet për gjendjen dhe azhurnimin e FDP-së janë në pasqyrën nr.9 të pasqyrave financiare.

6. (Kërkesa të tjera të arketueshme në vazhdim).

Lëvizja për zhvlerësime për kërkesa të tjera të dyshimta është si vijon:

Ne 000/lekë		
	31/12/2017	31/12/2016
Situma në 01 Janar 2017 (llog.416)	735,795	735,795
Shtese gjatë vitit	0	0
Pakësime gjatë vitit	0	0
Shuma në fund të periudhës/vitit	735,795	735,795

Kjo vlerë prej 735,795 mijë lekë ,sic përmendëm më lartë është e krijuar për shkaqe tashmë të njohura në vite,vlerë kjo e cila nuk ka shpresë arketimi,por nënvizojmë se për këtë vlerë është llogaritur zhvlefësimi i tyre,"e provigjonuar".

6.1 Shpenzime të shtyra.

Ne 000/lekë		
	31/12/2017	31/12/2016
Shpenzime të periudhave të ardhme (481)	0	5
Shpenzime të llogaritura	0	0
Interesa aktive të llogaritura	0	0
Te tjera		
Total	0	5

Nënvizojmë se shoqëria si rezultat i situatës së vështirë financiare ,prej disa vitesh nuk ka pajisur me uniforma punonjësit që duhet të përfillojnë veshmbathje ,shpenzime këto që duhet të kalojnë ushtrimeve me kuota pjesë.

7. Aktive Monetare.

Më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 gjendja e aktiveve monetare paraqitet si me poshte:

Ne 000/lekë		
	31/12/2017	31/12/2016
Gjendje në arkë (Kesh në dorë)	72	185
Gjendje në Banka (Kesh në Banka.)	7,517	3,307
Depozita afatshkurtra (kosto bileta)	0	0
Total (ne 000/lekë)	7,589	3,492

HEKURUDHA SHQIPTARE SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

